

V E N D I M
Nr. 46 datë 28.6.1999

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

Me sekretare Drita Filto, më datë 4.6.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.43 Akti që i përket :

K Ë R K U E S E: GJYKATA E LARTË, në mungesë.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE, i përfaqësuar nga Z.Z.Veli Budo e Viktor Gumi.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Z.Arben Murra.

O B J E K T I : Papajtueshmëria e nenit 481/2 të Kodit të Procedurës Civile me nenin 141/2 të Kushtetutës.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a dhe 134/d të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e subjekteve të interesuara dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Kryetari i Gjykatës së Lartë me vendimin datë 1.4.1999 ka vendosur që çështja civile me nr.1216, me palë ndërgjyqësa Marie Deda e Albert Akshia të gjykohet në Kolegjet e Bashkuara në bazë të nenit 481/2 të Kodit të Procedurës Civile për shkak të rëndësisë së veçantë që paraqet kjo çështje.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendosën pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për t'u shprehur për pajtueshmërinë e nenit 481/2 të Kodit të Procedurës Civile me nenin 141/2 të Kushtetutës lidhur me kompetencën e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit që të vendosë shqyrtimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara edhe të atyre rekurseve që ai mendon se paraqesin rëndësi të veçantë për shkak të karakterit të çështjes.

Sipas nenit 481/2 të Kodit të Procedurës Civile, kryetari i Gjykatës së Kasacionit mund të vendosë që Gjykata të shprehet në Kolegje të Bashkuara për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme e të mëparshme si dhe për ato rekurse që paraqesin rëndësi të veçantë për vetë karakterin e tyre.

Kompetenca që i ka dhënë Kodi i Procedurës Civile kryetarit të Gjykatës së Kasacionit për të vendosur kalimin e çështjes në Kolegje të Bashkuara edhe për shkak të rëndësisë së veçantë, nuk pajtohet me Kushtetutën, e cila i bën një rregullim të ndryshëm këtij problemi. Në nenin 141/2 të Kushtetutës thuhet: “Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegje të Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”. Përcaktimi në Kushtetutë se shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara bëhet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, është taksativ dhe nuk lejon që kjo tërheqje të zbatohet edhe për raste të tjera. Prandaj, kompetenca që paragrafi i dytë i nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile i ka dhënë kryetarit të Gjykatës së Kasacionit për të vendosur kalimin në Kolegje të Bashkuara të atyre rekurseve që ai mendon se paraqesin rëndësi të veçantë, nuk pajtohet me Kushtetutën dhe si e tillë duhet të shfuqizohet.

Rregulli i vendosur në nenin 178/1 të Kushtetutës sipas të cilit “Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar”, nuk mund të zbatohet në këtë rast sepse ai ka efekt vetëm për ato ligje apo akte normative që në tërësi apo në pjesë të veçanta të tyre nuk vinë në kundërshtim me dispozita konkrete të Kushtetutës. Një qëndrim i tillë është mbajtur nga Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin e saj të mëparshëm nr.77, datë 31.12.1998.

PER KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a dhe 134/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin në nenin 481/2 të Kodit të Procedurës Civile të fjalisë “si dhe për ato rekurse që paraqesin rëndësi të veçantë për vetë karakterin e tyre”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 28.6.1999

Nr. 43 irRegjistririt themeltar.

Nr. 46 i vendimit.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

Çështja nëse duhet ose jo të shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara, është e varur me natyrën konkrete të saj dhe me kriteret që përmban neni 141/2 i Kushtetutës si dhe me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile në fuqi.

Çështja objekt shqyrtimi, përfundimisht është gjykuar nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka deklaruar si antikushtetues vendimin e kolegjit civil nr.878, datë 13.6.1996. Si shkaqe për shfuqizimin, Gjykata Kushtetuese përmend se kolegji civil ka prishur të dy vendimet e ankmuara të gjykatave më të ulta dhe e ka gjykuar çështjen në fakt vetë duke vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 189 të ish-Kodit të Procedurës Civile në fuqi në atë kohë. Mirëpo, neni 189 që i korrespondon nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile sot në fuqi, nuk e parashikon të drejtën e kolegjit civil të prishë të dy vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, ç’ka formon proces jo të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 38 i Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Sipas procedurës, Gjykata e Kasacionit këtë çështje duhej ta kthente për rigjykim, por ajo duke vepruar ndryshe ka krijuar praktikë të kundërligjshme. Kështu që rasti konkret është i tillë që në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës imponohej njësimi i praktikës gjyqësore, për të mos u lejuar vazhdimi i një qëndrimi të tillë. Kjo i bënte të detyruara Kolegjet e Bashkuara ta pranonin kërkesën e kryetarit të Gjykatës e ta shqyrtonin çështjen për njësimin e praktikës gjyqësore si rast tipik për atë qëllim dhe të mos mbështeteshin në formulimin e shkresës përcjellëse vetëm sepse nuk përmendej njësimi i praktikës, por vetëm për rëndësinë e çështjes, megjithëse shkresa i referohej nenit 481/2 të Kodit të Procedurës Civile, që përfshin në radhë të parë njësimin e praktikës. Rëndësia e çështjes duhej kuptuar në lidhje me qëllimin e njësimi të praktikës gjyqësore. E vështuar çështja në këtë drejtë e kuptim themeli, kërkesa e kryetarit të Gjykatës së Lartë e mbështetur shprehimisht në nenin 481/2, kurrësesi nuk duhej të konkludohej në themel se vjen në kundërshtim me nenin 141/2 të Kushtetutës, kështu që në rastin konkret nuk ka ndeshje të dy dispozitave e për pasojë nuk duhej pranuar, por refuzuar kërkesa.

A N E T A R I
H. Dakli

Tiranë, më 28.6.1999
Nr. 43 i regjistrimit themeltar.
Nr. 46 i vendimit.